

**NJOFTIM  
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME  
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.**

Për: Z/Znj. \_\_\_\_\_ (Aksioner/Perfaqesues/e i/eAksionerit \_\_\_\_\_)

Ju njoftojmë se ditën e Merkurë datë 16 Maj ora 12:00 në ambientet e "BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Propozim për miratimin e ndryshimit të pjesëmarrjes influencuese në aksionet e shoqërisë Banka Credins sh.a., për shoqërinë "Amryta Capital", nëpërmjet blerjes së aksioneve nga shoqëria "Amryta Capital" nga aksionerë ekzistues të "Bankës Credins" sha, ku pas këtij transaksioni pjesëmarrja influencuese e shoqërisë "Amryta Capital" në kapitalin e Bankës Credins rritet.
2. Propozim për dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive date 16.05.2018 me rend dite si më poshtë:
  1. Mbi miratimin e shoqërisë që do të auditojë nën cilësinë e auditit të pavarur dhe ekspertit kontabël të autorizuar, pasqyrat financiare të Shoqërisë Administruese Credins Invest sh.a., si dhe pasqyrat financiare të fondeve nën administrim, fondit të pensionit "Credins Pension" dhe fondit të investimit "Credins Premium"
  2. Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, pasqyrave financiare vjetore të audituara të Shoqërisë Administruese Credins Invest sh.a., pasqyrave financiare të audituara të Fondit të Pensionit "Credins Pension", si dhe pasqyrave financiare të audituara të Fondit të Investimit "Credins Premium" për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017.
  3. Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit të Shoqërisë Credins Invest sh.a. për vitin e mbyllur më 31.12.2017.
  4. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.
5. Ngarkohet Drejtoria të beje njoftimet dhe regjistrimet perkatese ne perputhje me Ligjin.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

**Maltin KORKUTI**  
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**



Tirane me 25.04.2018

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionerët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»

- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».

- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.

- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.

- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionerët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.